



---

## NJOFTIM PËR PUNË PRAKTIKE PËR STUDENTËT E FAKULTETEVE JURIDIKE – 5 POZITA

---

Organizata jo-qeveritare “National Center for State Courts (NCSC)” ofron mundësi për punë praktike me pagesë për 5 studentë të fakulteteve juridike të akredituara në Kosovë, nga një student për secilin nga rajonet: Prishtinës, Prizrenit, Mitrovicës, Pejës dhe Gjilanit. Mundësia për punë praktike është e hapur në kuadër të Programit “Drejtësia ka rëndësi” dhe puna realizohet në zyret e organizatave jo-qeveritare partnere të programit. Kohëzgjatja e punës është dy (2) muaj, me mundësi vazhdimi deri në gjashtë (6) muaj.

### Mbi Programin Drejtësia ka Rëndësi

Drejtësia ka rëndësi është një program tre vjeçar për çasjen në drejtësi, i financuar nga Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe menaxhohet nga National Center for State Courts (NCSC) për të përmirësuar qasjen në drejtësi për të gjithë, përfshirë grupet e pafavorizuara dhe të marginalizuara, duke forcuar sistemet dhe shërbimet për ndihmë juridike falas dhe ofrimin e informative mbi ndihmën juridike falas.

Studentët e përzgjedhur do të mbështesin zbatimin e hulumtimit të Programit “Drejtësia ka rëndësi” në identifikimin e nevojave ligjore të komunitetit duke ndihmuar programin në hulumtim ligjor dhe realizimin e studimit në teren përmes intervistave të realizuara me pjesëtarët e komunitetit. Përveç kësaj, studentët e përzgjedhur do të ndihmojnë stafin e programit për të planifikuar ngjarje (p.sh. punëtori, fokus grupe) në kuadër të programit.

Kandidatët duhet të kenë:

- Shkathtësi të mira në hulumtim dhe shkrim ligjor dhe vëmendje në detaje;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe si pjesë e një ekipi;
- Aftësi në komunikim me publikun;
- Fleksibilitet për punë në teren;
- Njohuri të avancuara të gjuhës angleze dhe zotërim të mirë të njëres nga gjuhët zyrtare të Kosovës.
- Preferohen aplikacionet nga studentët e vitit të tretë dhe katërt ose student të programit master.

### Dokumentet e kërkuara

Studentët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim në emailin [info@ncsc-ks.org](mailto:info@ncsc-ks.org):

- CV-ja
- Letër motivuese në të shprehet mendimi juaj se pse është e rëndësishme drejtësia për ta
- Çertifikata e notave dhe ndonjë çertifikatë të punës praktike të mëhershme, apo ndonjë reference.

Për të aplikuar dërgoni me email dokumentet e kërkuara në adresën e e-mailit me subjektin “NCSC Justice Matters Internship” deri më **09 korrik 2018 në ora 24:00**. Për shkak të numrit të madh të kandidatëve, vetëm kandidatët në listën e ngushtë do të kontaktohen. Asnjë telefonatë nuk pranohet lidhur me këtë përzgjedhje dhe çfarëdo përpjekje për të kontaktuar NCSC apo USAID do të rezultojë në diskualifikim të menjëhershëm.